



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:100737

Datë: 09.10.2024

Numri i dokumentit: 06274282

C.nr.1661/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtare Diora Bajrami, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve B.T. me numër personal L.Sh. me numër personal K.O. me numër personal L.Sh. me numër personal dhe I.Q. me numër personal të gjithë nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë avokatët B.K. dhe F.G. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 1750.31 euro, jashtë seance, me datë 09.10.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve B.T., L.Sh., K.O. dhe I.Q. të gjithë nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve të kompensohen në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Paditëses B.T.

- Për periudhën kohore Shtator - Dhjetor 2020, në shumën prej 3.14 euro;
- Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 160.34 euro,
- apo shumën e përgjithshme prej 163.48 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (16.05.2022), e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

2. Paditëses L.Sh.

- Për periudhën kohore Tetor - Dhjetor 2019 në shumën prej 90.93 euro;
- Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 10.10 euro;
- Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.76 euro,
- apo shumën e përgjithshme prej 272.79 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (16.05.2022), e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

3. Paditëses K.O.

- Për periudhën kohore Maj - Dhjetor 2019 në shumën prej 52.20 euro;
- Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 5.80 euro;
- Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 98.60 euro,

- apo shumën e përgjithshme prej 156.6 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (16.05.2022), e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

4. Paditësit I.Q.

- Për periudhën kohore Tetor - Dhjetor 2019 në shumën prej 90.93 euro;
- Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 10.10 euro;
- Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.76 euro,
- apo shumën e përgjithshme prej 272.79 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (16.05.2022), e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

5. Paditëses L.Sh.

- Për periudhën 01.05.2019 deri me dt. 25.11.2019, në shumën prej 79.52 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (16.05.2022), e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

III. REFUZOHET e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë të paditësve përtej shumës së gjykuar sikurse në pikën II të këtij dispozitivi të këtij aktgjykimi, apo paditësit B.T. iu refuzua shuma prej 20.05euro, paditëses L.Sh. iu refuzua shuma prej 215.4 euro, paditëses K.O. iu refuzua shuma prej 137.52 euro, paditësit I.Q. iu refuzua shuma prej 228.15 euro, ndërsa paditësit L.Sh. iu refuzua shuma prej 205.6 euro.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, që paditësve në emër të shpenzimeve të procedurës, tua paguaj shumën prej 342.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit B.T., L.Sh., K.O. dhe I.Q. të gjithë nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë avokatët B.K. dhe F.G. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi me dt. 16.05.2022, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit-Prizren, me objekt të kontestit për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

I autorizuari i paditësve në padi ka theksuar, se paditësit janë të punësuar pranë SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në Pllanejë, Komuna e Prizrenit. Tutje, ka theksuar se duke u bazuar në nenin 35 par.10, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve në tërësi si të bazuar dhe atë për periudhën prej 01.01.2020 deri me dt. 31.12.2021. Shpenzimet e procedurës kontestimore i kanë kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 04.08.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar. Pretendimet e paditësve se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK. Paditësit ushtrojnë padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se ju takojnë beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së, saktësisht për vitin 2017 e deri me datë 18.04.2021. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpapia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqësve të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga vërtetimet të lëshuara nga këtu e paditura SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në fshatin Pllanejë, Komuna e Prizrenit, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në fshatin Pllanejë, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënës.

Sipas vërtetimit me nr. 35/2022 e datës 10.03.2022 e lëshuar nga e paditura për paditësen B.T. gjykata ka vërtetuar se e njejta ka filluar të punoj tek e paditura që nga data 14.09.2020 dhe vazhdon të punoj.

Në bazë të vërtetimit me nr. 42/2022 e datës 10.03.2022 e lëshuar nga e paditura për paditësen L.Sh. gjykata ka vërtetuar se e njejta ka filluar të punoj tek e paditura që nga data 07.02.2017 dhe vazhdon të punoj.

Në bazë të vërtetimit me nr. 41/2022 e datës 10.03.2022 e lëshuar nga e paditura për paditësen K.O. gjykata ka vërtetuar se e njejta ka filluar të punoj tek e paditura që nga data 21.01.2013 dhe vazhdon të punoj.

Në bazë të vërtetimit me nr. 50/2022 e datës 21.03.2022 e lëshuar nga e paditura për paditësin L.Sh. gjykata gjeti se i njejti ka filluar të punoj tek e paditura që nga data 01.09.1974 deri me datë 25.11.2019.

Në bazë të vërtetimit me nr. 39/2022 e datës 10.03.2022 e lëshuar nga e paditura për paditësin I.Q. gjykata ka vërtetuar se i njëjti ka filluar të punoj tek e paditura që nga data 01.09.2009 dhe vazhdon të punoj.

Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2019, 2020, 2021 vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësve dhe atë, paditësit L.Sh. dhe I.Q. si mësimdhënës tek e paditura kanë pagën bazë në shumë prej 421 euro, ndërsa paditësja B.T. si mësimdhënëse tek e paditura ka pagën bazë në shumë prej 393 euro dhe Kada Osmanaj, pagën bazë e ka të përcaktuar sipas koeficientit 4/1, e që sipas Vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e datës 11.12.2023 e njëjta si punëtore tek e paditura, realizon pagën bazë në shumë prej 241.68 euro.

Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu falë besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëseve u takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Paditëses B.T.

- Për periudhën 14.09.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 393 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 3.14 euro ($393 \cdot 0.2\% = 0.78 \cdot 4 \text{ muaj} = 3.14 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 393 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 160.34 euro ($393 \cdot 3.4\% = 13.36 \cdot 12 \text{ muaj} = 160.34 \text{ euro}$).
- Në shumë të përgjithshme 163.48 euro për periudhën 14.09.2020-31.12.2020.

Paditësit L.Sh. dhe paditësi I.Q.

- Për periudhën 01.05.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 90.93 euro ($421 * 2.7\% = 11.36 * 8 \text{ muaj} = 90.93 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro ($421 * 0.2\% = 0.84 * 12 \text{ muaj} = 10.10 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.76 euro ($421 * 3.4\% = 14.31 * 12 \text{ muaj} = 171.76 \text{ euro}$).
- Secilit paditës veç e veç i takon shuma prej 272.79 euro për periudhën 01.05.2019-31.12.2021.

Paditëses K.O.

- Për periudhën 01.05.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 241.68 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 52.20 euro ($241.68 * 2.7\% = 6.52 * 8 \text{ muaj} = 52.20 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 241.68 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 5.80 euro ($241.68 * 0.2\% = 0.48 * 12 \text{ muaj} = 5.80 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 241.68 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 98.60 euro ($241.68 * 3.4\% = 8.21 * 12 \text{ muaj} = 98.60 \text{ euro}$).
- I takon shuma prej 156.6 euro për periudhën 01.05.2019-31.12.2021.

Paditësit L.Sh.

- Për periudhën 01.05.2019 deri me dt. 25.11.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2019 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është euro ($421 * 2.7\% = 11.36 * 7 \text{ muaj} = 79.52 \text{ euro}$).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë

ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”,* pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.* Në këtë drejtim, paditësit padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 16.05.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëseve iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë 30.04.2019. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 2 vite e 1 muaj, ndërsa paditësit e kanë ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe e kanë ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tyre në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë me datë 16.05.2022. Në këtë drejtim paditësve L.Sh, K.O., L.Sh. dhe I.Q. të gjithë nga Prizreni, në emër të kompensimit shtesë për shkak të rritjes së inflacionit, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 30.04.2019 apo për 25 muaj iu refuzua një pjesë të kërkesëpadiës.

Andaj mbi këtë bazë gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditësve sikurse në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë sa i përket parashkrimit të kërkesës për 2 vite e 1 muaj (nga data 18.04.2017 deri me dt. 30.04.2019) si dhe duke e minusuar shumën e kërkuar në raport me pagën bazë të kërkuar nga paditësit dhe atë që në të vërtetë e realizojnë ashtu që paditëses B.T. nga shuma e kërkuar prej 183.53 euro iu refuzua shuma prej 20.05 euro, paditëses L.Sh. nga shuma e kërkuar prej 488.19 euro iu refuzua shuma prej 215.4 euro, paditëses K.O. nga shuma e kërkuar prej 294.12 euro iu refuzua shuma prej 137.52, paditësit I.Q. nga shuma e kërkuar prej 500.94 euro iu refuzua shuma prej 228.15 euro ndërsa paditësit L.Sh. nga shuma e kërkuar prej 285.12 euro iu refuzua shuma prej 205.6 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (16.05.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 30.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 342.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2022:100737
Datë: 09.10.2024
Numri i dokumentit: 06274282

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C.nr.1661/2022, datë 09.10.2024

Gjyqtarja
Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.